



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 552/prot
16

Koplik më: 10 / 05 / 2024

V E N D I M

Nr 27 datë 30 /04 / 2024

PËR

1. "Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të z. Petrit Mjacaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit Petrit Mjacaj nga programi Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 3280, në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr 6 datë 18.01.2024 "për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afat mesem 2024-2026 të Bashkisë Malësi e Madhe".

Baza Ligjore

Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar

Ligji për Prefektin e Qarkut

Ligji Nr.45/2019 Për mbrojtjen civile,

VKM nr.329 datë 16/5/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"

VKM, Nr.965, datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndër-institucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

Vendosi;

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetasit z. Petrit Mjacaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit,
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko - ligjor përkatës të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për dëmtimin e banesë nga rënia e zjarrit.

3. T'i akordojë familjes së shtetasit Z. Petrit Mjacaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, dhënien e ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vleren/shumen 100.000 (njeqind mijë) lekë, në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr.6, datë, 18.01.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 të Bashkisë Malësi e Madhe", nga fondi i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe, nga Programi "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 03280".

4. T'i paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të familjes së shtetasit Z. Petrit Mjacaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.

5. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Z. Petrit Mjacaj, përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.

6. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit **Z. Petrit Mjaca**, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.

7. Vlera e dëmeve në orëdi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake është 160.200 (njqind e gjashtedhjetë mijë e dyqind) lekë.

Vler e dëmeve nga ana ndërtimore është 355.967 (treqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nentqind e gjashtedhjetë e shtatë) lekë

Vlera në total e dëmeve është : 516.167 (peseqind e gjashtembedhjetë mijë e njqind e gjashtedhjetë e shtatë) lekë.

8.Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 30.04.2024

Vota Pro 21

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me date 07.05.2024

